



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 801/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji "Iliria" për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2018:

- Juridik, LLB, 240 ECTS, (me specializime: 1. I Përgjithshëm; Civil; Penal; Administrativ – Kushtetues; Ndërkombëtar; Financiar), (maksimum 300 student për vit akademik);
- Juridik Civil, LLM, 60 ECTS, (maksimum 100 student për vit akademik);
- Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS (me specializime: IT e Aplikuar; Robotikë; Informatika për Biznes), (maksimum 200 student për vit akademik).

II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

III. Obligohet BPrAL Kolegji "Iliria" që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

IV. Obligohet BPrAL Kolegji "Iliria" që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Juridik	LLB	240	Bekim Kadriu, Rita Loloci (filozofi), Hekuran Rapaj (histori)
2	Juridik Civil	LLM	60	Besmir Alushi, Luljeta Kodra, Fatmir Tartale (penal)
3	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Halim Halimi, Nderim Zeqiri, Artan Luma

AKA ka organizuar vizitë në BPrAL Kolegji "Iliria" më 11.08.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Frederic Mertens de Wilmads; Prof. Dr. Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Iliria", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) megjithatë ka konsideruar se raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit numëron vërejtje të shumta për programet e studimit të Kolegjit Iliria, prandaj vendosi që programet e studimit të ri/akreditohej për një periudhë vjeçare prej 2 viteve.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Iliria"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë